



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.10.2019, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Enver Roshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nen për nen i projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9942, datë 26.6.2008, "Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut", të ndryshuar".

Marrin pjesë:

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Ardiana Jaku, Almira Xhembulla, Majlinda Halilaj, Florenc Spaho, Eugen Bojaxhiu, Amra Barova, Koçi Tahiri, Edmond Stojku, Halil Jakimi, Ervis Meço.

Mungojnë:

Roland Xhelilaj, Klotilda Bushka.

Të ftuar:

Mira Rakacolli – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Vjollca Braho – Kryeinspektore në Inspektoratin Shëndetësor Shtetëror

Antoneta Njehrrëna –Drejtoresh e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në MSHMS

Ardian Paravani - përfaqësues i Inspektoratit Shëndetësor Shtetëror

HAPET MBLEDHJA

Enver Roshi – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e komisionit me këtë rend dite: shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9242, datë 26.06.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut”, të ndryshuar”.

Të ftuar nga Ministria e Shëndetësisë janë: zonja Vjollca Braho, kryeinspektore në Inspektoratin Shëndetësor Shtetëror, zonja Antoneta Njehrrëna, drejtore e Programit të Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator si edhe zoti Ardian Paravani, përfaqësues i Inspektoratit Shëndetësor Shtetëror.

Kalojmë në shqyrtimin e ligjit nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 2. “Në nenin 3 termat: “konsum direkt dhe konsum indirekt” zëvendësohen përkatësisht me termat: “konsum i drejtpërdrejtë dhe konsum i tërthortë”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. “Në nenin 9 pas paragrafit të parë, shtohet paragrafi me përmbajtjen si më poshtë vijon: Lejohet importimi i kripës ushqimore të pajodizuar vetëm për qëllimin e fortifikimit të kripës me jod nga subjektet e licencuara për këtë qëllim sipas legjislacionit në fuqi për licencimin duke garantuar gjurmueshmërinë e kripës së jodizuar”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Paragrafi 2 hiqet, sepse, sipas OBSH-së dhe UNICEF-it, nuk ka asnjë referencë shkencore.

Në paragrafin 3, që bëhet paragrafi 2, thuhet: “Lejohet eksporti i kripës së pajodizuar dhe i ushqimeve të prodhuara me kripë të pajodizuar duke garantuar gjurmueshmërinë në procesin e eksportit”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Antoneta Njehrrëna – Në seancën dëgjimore përfaqësuesi i doganave kishte një propozim sipas të cilit duhet të bëhet i mundur dërgimi i listës së vendeve që përdorin kripën e pajodizuar, sepse aktualisht kjo listë nuk ekziston në dogana. Ju lutem, përfaqësuesve të Ministrisë së Shëndetësisë që të bëjnë të mundur realizimin dhe hartimin e kësaj liste dhe dërgimin në pikat doganore.

Enver Roshi – Më shumë është problemi i ushqimeve të prodhuara. Për të mos e rikthyer prapë në vend, sepse hapet një lojë e rrezikshme, është vënë shprehja: “duke garantuar gjurmueshmërinë në procesin e eksportit”.

Antoneta Njehrrëna - Në variantin e qeverisë ishte parashikuar propozimi për vendet. Në variantin e propozuar nga ju sigurohet vetëm gjurmueshmëria. Gjithsesi, ministria do të bëjë të pamundurën, por është vështirë që të gjesh të gjitha vendet.

Klodiana Spahiu - Nëse këto vende ju i dini, ju lutem këtë listën duhet t’ua dërgoni pikave doganore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enver Roshi - Neni 12. Pika 1 e nenit 12 riformulohet si më poshtë vijon: 1. Kripa e jodizuar, e prodhuar ose e importuar e destinuar të tregtohet në Republikën e Shqipërisë, është objekt kontrolli, i cili përfshin veprimtarinë e mëposhtme: monitorimin, i cili kryhet nga drejtoritë rajonale dhe vendore të shëndetësisë; inspektimin, i cili kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e shëndetësisë; 2. Pas pikës 4 shtohen pikat 5 dhe 6 me përmbajtje si më poshtë: “5. Shpenzimet për marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave laboratorike të nevojshme për kontrollin e kripës së jodizuar përballohen nga importuesi, tarifat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. 6. Kripa e jodizuar, që importohet në Republikën e Shqipërisë nga subjekte importuese, i nënshtrohet kontrollit në pikat doganore. Ky kontroll kryhet nga autoritetet doganore në përputhje me parashikimet e legjislacionit doganor drejtoritë rajonale dhe vendore të shëndetësisë dhe inspektorati që mbulon fushën e shëndetësisë”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5 është hequr.

Kalojmë te neni 6, i cili bëhet neni 5. Në nenin 13 bëhen ndryshimet si më poshtë vijon: “Në pikën 1 të nenit 13 fjalët “inspektorati sanitar shtetëror” zëvendësohet me fjalët “drejtoritë

rajonale dhe vendore te shëndetësisë”. Pika 3 e nenit 13 hiqet. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet

Kalojmë te neni 7 që bëhet neni 6. Pas nenit 13 / 1 shtohet neni 13/2 me këtë përmbajtje: “Kërkesat për gjurmueshmërinë e kripës për konsum human shtazor dhe përdorim në industrinë ushqimore. Operatori i biznesit ushqimor krijon dhe mban informacionin e nevojshëm për gjurmueshmërinë në të gjitha fazat e prodhimit, jodizimit përpunimet e kripës dhe shpërndarjes së saj;

2. Informacioni i nevojshëm për gjurmueshmërinë përfshin këto të dhëna: identitetin e çdo subjekti tregtar person juridik ose fizik, nga i cili operatori i biznesit ushqimor është furnizuar me kripë; identitetin e çdo subjekti tregtar të cilin operatori i biznesit ushqimor e ka furnizuar me kripë.

3. Operatori i biznesit ushqimor ruan të dhënat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, por jo më pak se tre vjet dhe siguron që këto të dhëna t’i jepen menjëherë ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe inspektoratit përgjegjës për Shëndetësinë.

4. Kripa ushqimore e nxjerrë në treg ose që mund të nxirret në treg duhet të etiketohet dhe identifikohet nëpërmjet dokumenteve dhe çdo lloj informacioni tjetër për të siguruar gjurmueshmërinë”.

Ilir Pendavinji - Mbase në vend të: “konsum human” duhet të shkruhet: “konsum njerëzor”. Edhe në ligj konsum njerëzor është.

Enver Roshi - Atëherë, ndryshon: “Kërkesa për gjurmueshmërinë e kripës për konsum njerëzor, shtazor dhe përdorim në industrinë ushqimore”.

Miratohet neni 6.

Kalojmë te neni 7. “ Ngarkohet Këshilli i Ministrave brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 4, pika 5 të këtij ligji. Ngarkohet ministri përgjegjës për Shëndetësinë”.

(Diskutime pa mikrofon)

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Dakord.

Neni 8. “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

MBYLLET MBLEDHJA